



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 206 prot.

Tiranë, më 30.01.2026

URDHËR

NR. 26, DATË 30.01.2026

PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TË THELLUAR, NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL, GJATË APLIKIMIT TË INSTITUTIT TË TRANSFERIMIT PËR PUNONJËSIT GJERGJI SMOKTHINA, ALTIN DEMIRAJ, ASQERI MIRASHI DHE INSTITUTIT TË PEZULLIMIT PËR PUNONJËSIT BESNIK SEFERAJ, EDVIN GRUÇKA DHE AGRON NUREDINAJ, NË INSTITUCIONIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Në mbështetje të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, si dhe neneve 2; 14 germa a), 16; 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, duke vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme për shkelje të rregullave të administrimit të shërbimit civil, nga subjekte të ngarkuara nga ligji për nëpunësin civil me detyra të veçanta, si dhe në kushtet e mungesës së bashkëpunimit nga ana e institucionit me Komisionerin, gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore të këtij të fundit,

URDHËROJ:

1. Nisjen e inspektimit për verifikimin e zbatimit të ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil, nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve dhe Departamenti i administratës Publike, për aplikimin e institutit të transferimit në shërbimin civil në rastin e nëpunësve Gjergji Smokthina, Altin Demiraj dhe Asqeri Mirashi, si dhe për aplikimin e institutit të pezullimit nga shërbimi civil, në rastin e nëpunësve Besnik Seferaj, Edvin Gruçka dhe Agron Nuredinaj.
2. Inspektimi do të përfshijë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Drejtorisë së

Përgjithshme të Tatimeve, si dhe subjektet/mekanizmat e tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të transferimit dhe pezullimit në shërbimin civil.

3. Procesi i inspektimit do të fillojë në datën **03.02.2026**, me paraqitjen e grupit të punës pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe do të vijojë me mbledhjen e të dhënave, deri në datën **06.02.2026**. Inspektimi do të përmbyllet nëpërmjet relacionit përfundimtar të grupit të punës dhe vendimit përkatës të Komisionerit, brenda datës **03.03.2026**.
4. Për çdo parregullsi të konstatuar do të mbahet akt konstatimi dhe do të administrohet kopja e dokumentacionit përkatës, e vërtetuar me origjinalin nga sekretaria e institucionit.
5. Grupi i inspektimit do të ketë përbërjen si më poshtë:

| | |
|----------------------|---|
| Luiseda Zhapa | Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ (Drejtues grupi) |
| Zamira Mujali | Inspektore (Anëtar) |
| Sabina Liço | Inspektore (Anëtar) |

6. Inspektimi do të orientohet drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil, të një kategorie veprimesh administrative në këtë institucion, në lidhje me institutet e ligjit që janë objekt i këtij procesi, sipas këtyre drejtimeve:
 - a. Verifikimi i statusit të punonjësve në rastet e evidentuara në këtë urdhër.
 - b. Procedura e ndjekur nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë DPT-së; njësia përgjegjëse DAP, apo subjekte të tjera që kanë kryer veprime administrative në këto raste, e materializuar në veprimet konkrete të ndërmarra për miratimin e aktit të transferimit të punonjësve, apo të pezullimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil.
 - c. Veprimet administrative të kryera nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë DPT-së si edhe njësia përgjegjëse DAP, për rikthimin e nëpunësve civilë në pozicionet ku kanë pasur emërimin e rregullt, në përfundim të afatit të transferimit, apo emërimin e nëpunësit civil në të njëjtin pozicion apo në një pozicion të barazvlefshëm, pas ndërprerjes së pezullimit.
7. Baza ligjore mbi të cilën do të kryhet verifikimi i veprimeve të kryera, është:
 - Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 48, kreu VIII, “Transferimi në shërbimin civil” dhe kreu IX, “Pezullim nga shërbimi civil”, i këtij ligji;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.124, datë 17.2.2016, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i ndryshuar.
 - Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
 - Ligji nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
8. Për të përfunduar këtë proces, grupit të inspektimit duhet t’i vihen në dispozicion të gjitha aktet administrative të depozituara në dosjet personale të nëpunësve civilë të evidentuar në këtë urdhër, të cilat dokumentojnë procedurën e ndjekur gjatë zbatimit të institutit të transferimit apo institutit të pezullimit të marrëdhënies së tyre të punësimit në shërbimin civil.
 9. Grupit të inspektimit do ti vihet në dispozicion, çdo material tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm për verifikimin e situatës, sipas objektit të procesit.
 10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe grupi i inspektimit, që të marrë masat për realizimin e procesit të inspektimit, duke filluar me njoftimin e subjekteve që do t’i nënshtrohen inspektimit, që janë: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
 11. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masat e nevojshme që të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit.
 12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)